



Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

DITA BOTËRORE PA DUHAN

Tema: “Demaskimi i joshjes-luftimi i varësisë nga nikotina dhe duhani”

Data: 31 Maj – Dita Botërore Kundër Duhanit

Organizator: Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK)

Partnerë: Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHT), komunat e Kosovës

Më 31 maj shënohet Dita Botërore pa duhan. Me qëllim të shënimit të kësaj dite, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Arsimit, Shkencës e Teknologjisë dhe komunat, organizon një aktivitet kreativ me nxënës, më qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit për pasojat shëndetësore, ekonomike e sociale të duhanpirjes.

QËLLIMI I AKTIVITETIT

- Rritja e vetëdijes tek nxënësit për dëmet e duhanit dhe të cigareve elektronike
- Angazhimi i të rinjve si “ambasadorë” të shëndetit publik
- Inkurajimi i nxënësve për të reflektuar mesazhe kundër duhanpirjes në formë kreative

PJESËMARRËS

- Nxënës të klasave 6–9 të shkollave nga të gjitha komunat e Kosovës
- Mësues dhe drejtues shkollash për udhëzimin e nxënësve

FORMATI I AKTIVITETIT

Garë e organizuar në mesin e nxënësve në këto kategori:

- Vizatim apo poster mesazh kundër duhanit
- Video mesazh 1–3 minuta
- Animacion

Shpjegim: Nxënësit gjatë garës do të përcaktohen për njërën nga kategoritë e propozuara

KRITERET E VLERËSIMIT

Me qëllim të vlerësimit të punimeve të nxënësve të përzgjedhur në komuna për t’i përfaqësuar në finale, do të formohet një Komision i përbashkët (IKSHPK + MSh + MASHT + përfaqësuesi i komunave + ekspert komunikimi), i cili do të analizojë:

- Saktësinë e mesazhit
- Kreativitetin
- Ndikimin emocional dhe argumentues
- Qartësinë dhe fuqinë e mesazhit
- Përfshirjen e statistikave (evidencave) reale të duhanpirjes në Kosovë në punime

ORGANIZIMI I AKTIVITETEVE

Faza 1 – Njoftimi i shkollave (deri më 15 mars)

- Njoftohen MSH, MASHTI dhe merret mbështetja prej tyre
- Dërgohet thirrje zyrtare në shkollat që do të përfshihen në garë të përzgjedhura përmes Drejtorive komunale për Arsim
- Publikohet udhëzuesi për kategoritë me kriteret
- Postohet në ueb dhe rrjete sociale njoftimi publik për garën
(Aktiviteti zhvillohet brenda shkollave dhe në nivel komunal deri më 30 prill)

Faza 2 – Përzgjedhja në nivel komunal

- Çdo komunë (Drejtoria e Arsimit) përzgjedh 3 punimet më të mira nga shkollat e tyre, të cilat i dërgon në IKSHPK, më së voni deri më **10 Maj**

Faza 3 – Finalja (29 Maj - E Premte)

- Mbahet në sallën e IKSHPK
- Mbahen fjalimet zyrtare nga përfaqësuesit e institucioneve
- Shpallen fituesit e çmimeve
- Ndahen certifikatat për fituesit

Sigurohet mbulim medial (Ftohen mediat, fituesit e garës dhe përfaqësues të IKSHPK marrin pjesë në emisione në media për të informuar për aktivitetet dhe sensibilizuar kundër përdorimit të nikotinës dhe duhanit).

ÇMIMET

1. Çmimi i parë

- Certifikatë për vendin e I-rë /“Ambasador i Shëndetit Publik 2026”

2. Çmimi i dytë:

- Certifikatë për vendin e II-të

3. Çmimi i tretë

- Certifikatë për vendin e III-të

Posterët fitues ekspozohen në hollin ku mbahet event i final, në IKSHPK

- Hashtagu zyrtar: #KosovaPaDuhan
- Produktet fituese (Vizatimi, animacioni, etj., publikohen në materialet dhe rrjetet sociale të IKSHPK-së: fletëpalosjet informuese, FB dhe Instagram)

Deklarata e të rinjve

Me qëllim të sensibilizimit të të rinjve për pasojat e duhanpirjes, nxënësit finalistë lexojnë një **Deklaratë të të Rinjve për një Kosovë pa duhan**, e cila publikohet zyrtarisht (opcionale: mund edhe të nënshkruhet nga pjesëmarrësit në ngjarje).

Deklarata përgatitet nga IKSHPK.

Përfitimet për nxënësit

- Rritje e vetëdijes për shëndetin dhe përfitimet e jetës pa duhan
- Eksperiencë krijuese dhe prezantimi publik
- Çmime dhe certifikata për punimet më të mira



Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

RREGULLORE E GARËS

Rregullorja e Garës Kombëtare “Të rinjtë për një Kosovë pa duhan”

Neni 1 – Organizatori

Gara organizohet nga IKSHPK në bashkëpunim me MSH, MASHT dhe komunat e Kosovës.

Neni 2 – Pjesëmarrësit:

Nxënës të klasave 6–9 shkollat publike dhe private në Kosovë të përzgjedhura nga Komunat.

Neni 3 – Kategoritë:

- Vizatim apo poster mesazh kundër duhanit
- Video mesazh 1–3 minuta
- Animacion

Neni 4 – Tematika

“Demaskimi i joshjes-luftimi i varësisë nga nikotina dhe duhani”

Neni 5 – Procedura e garës

- Çdo shkollë mund të paraqesë deri në 3 punime për kategori
- Afati për vlerësimin e punimeve në komuna nga drejtoritë komunale (komisionet lokale) deri më **30 prill**
- Afati për dorëzimin e punimeve në IKSHPK nga drejtoritë komunale të arsimit deri më **10 Maj 2026**.
- Përzgjedhja komunale – secila komunë përzgjedh 3 punimet më të mira
- Në komisionet (juritë) vlerësuese në komuna merr pjesë edhe përfaqësuesi i IKSHPK
- Finalja në nivel nacional – prezantimi publik më 31 Maj në Prishtinë

Neni 6 – Kriteret e vlerësimit

- Saktësinë e mesazhit
- Kreativitetin
- Ndikimin emocional dhe argumentues
- Qartësinë dhe fuqinë e mesazhit
- Përfshirjen e statistikave (evidencave) reale të duhanpirjes në Kosovë në punime

Neni 7 – Çmimet

- *Çmimi i Parë*: Certifikatë për vendin e I-rë /“Ambasador i Shëndetit Publik 2026”
- *Çmimi i Dytë*: Certifikatë për vendin e II-të
- *Çmimi i Tretë*: Certifikatë për vendin e III-të

Neni 8 – Publikimi

Punimet fituese do të publikohen në rrjetet sociale të IKSHPK-së, në materialit informuese si fletëpalosjet apo broshura, do të ekspozohen në hollin e institucionit, në qendra tregtare dhe institucione publike.

Neni 9 – Dispozita përfundimtare

Gara ka karakter edukativ dhe nuk mund të përdoret për qëllime politike apo komerciale.

Prishtinë, 11 mars 2026

